



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## BASHKIA TIRANË

### FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT (PAS PËRFUNDIMIT TË AFATEVE TË ANKIMIT)

Drejtuar: **Operatorit ekonomik “DAJTI PARK 2007” shpk**  
Adresa: Rr. Bardhok Biba, Pallati Trema, Hyrja C, KODI POSTAR 1016, Tiranë.

Procedura e prokurimit/lotit: **“Procedurë e Hapur”, Zgjerimi i hapësirave të varrezave publike Tufinë”**.

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-45637-10-12-2022**

**Përshkrimi i shkurtër i kontratës:** Qëllimi i kontratës është: **“Zgjerimi i hapësirave të varrezave publike Tufinë”**.

**Fondi limit: 91,516,148.11** (nëntëdhjetë e një milion e pesëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e njëqind e dyzet e tetë pikë njëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

**Burimi i financimit:** vënë në dispozicion nga të ardhurat e Bashkisë Tiranë për vitin 2022, miratuar me VKB Nr.166, datë 24.12.2021 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2022-2024 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2022” rialokuar me VKB Nr.126 datë 23.12.2022 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 dhe detajimin e buxhetit të bashkisë tiranë për vitin 2023”.

**Kohëzgjatja e kontratës:** 5 (pesë) muaj kalendarik duke nisur nga data e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes për të njëjtin objekt.

Publikimet e mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike Nr.19, datë 27.02.2023.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

**1. Operatori ekonomik “L.T.E CONSTRUCTION” shpk** NUIS 78006801F  
Vlera e ofertës = 53,590,426 (pesëdhjetë e tre milion e pesëqind e nëntëdhjetë mijë e katërqind e njëzet e gjashtë) lekë pa TVSH.

**2. Operatori ekonomik “DAJTI PARK 2007” shpk** NUIS K11507003S  
Vlera e ofertës = 57,503,314 (pesëdhjetë e shtatë milion e pesëqind e tre mijë e treqind e katërmëdhjetë) lekë pa TVSH.

**3. Bashkimi i operatorëve ekonomike “GLAVENICA” shpk & “NGRACAN 1934” shpk** NUIS K17710805A; J87602809S

Vlera e ofertës = 61,423,988 (gjashtëdhjetë e një milion e katërqind e njëzet e tre mijë e nëntëqind e nëntëqdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

**4. Bashkimi i operatorëve ekonomike “XHENGO” shpk & “BOSHNJAKU. B” shpk**  
NUIS J64103171M; K72627402H

Vlera e ofertës = 64,297,184 (gjashtëdhjetë e katër milion e dyqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e tetëdhjetë e katër) lekë pa TVSH.

**5. Bashkimi i operatorëve ekonomike “BEQIRI” shpk & “B93 II” shpk**  
NUIS J98624801V; L522090500

Vlera e ofertës = 67,112,907.49 (gjashtëdhjetë e shtatë milion e njëqind e dymbëdhjetë mijë e nëntëqind e shtatë pikë dyzet e nëntë) lekë pa TVSH.

**6. Operatori ekonomik “ALBAVIA” shpk** NUIS J81527001Q

Vlera e ofertës = 67,350,641.3 (gjashtëdhjetë e shtatë milion e treqind e pesëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzet e një pikë tre) lekë pa TVSH.

**7. Operatori ekonomik “BE - IS” shpk** NUIS K71412003A

Vlera e ofertës = 68,541,949 (gjashtëdhjetë e tetë milion e pesëqind e dyzet e një mijë e nëntëqind e dyzet e nëntë) lekë pa TVSH.

**8. Operatori ekonomik “SHPRESA - AL” shpk** NUIS K31321021N

Vlera e ofertës = 69,506,040 (gjashtëdhjetë e nëntë milion e pesëqind e gjashtë mijë e dyzet) lekë pa TVSH.

**9. Operatori ekonomik “KTHELLA” shpk** NUIS J69303023D

Vlera e ofertës = 71,116,091 (shtatëdhjetë e një milion e njëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e nëntëdhjetë e një) lekë pa TVSH.

**10. Operatori ekonomik “K A C D E D J A” shpk** NUIS K51712017A

Vlera e ofertës = 72,251,960.34 (shtatëdhjetë e dy milion e dyqind e pesëdhjetë e një mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë pikë tridhjetë e katër) lekë pa TVSH.

**11. Operatori ekonomik “DENIS-05” shpk** NUIS K51518029B

Vlera e ofertës = 74,559,799.18 (shtatëdhjetë e katër milion e pesëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e nëntë pikë tetëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

**12. Operatori ekonomik “ALMO KONSTRUKSION” shpk** NUIS J91915001P

Vlera e ofertës = 75,036,952.73 (shtatëdhjetë e pesë milion e tridhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e dy pikë shtatëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.

**13. Operatori ekonomik “BAJRAMI N.” shpk** NUIS K027272020

Vlera e ofertës = 76,827,142.35 (shtatëdhjetë e gjashtë milion e tetëqind e njëzet e shtatë mijë e njëqind e dyzet e dy pike tridhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

**14. Operatori ekonomik “S I R E T A 2F” shpk** NUIS K51501008J

Vlera e ofertës = 77,788,271 (shtatëdhjetë e shtatë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e një) lekë pa TVSH.

**15. Operatori ekonomik “LEON KONSTRUKSION” shpk** NUIS K71820009I

Vlera e ofertës = 78,703,529 (shtatëdhjetë e tetë milion e shtatëqind e tre mijë e pesëqind e njëzet e nëntë) lekë pa TVSH.

**16. Operatori ekonomik “PEPA GROUP GROUP” shpk** NUIS L42215009L  
Vlera e ofertës = 80,025,327.6 (tetëdhjetë milion e njëzet e pesë mijë e treqind e njëzet e shtatë pikë gjashtë) lekë pa TVSH.

**17. Operatori ekonomik “LIQENI VII” sh.a** NUIS K01730502W  
Vlera e ofertës = 81,368,994 (tetëdhjetë e një milion e treqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e katër) lekë pa TVSH.

**18. Operatori ekonomik “SHANSI INVEST” shpk** NUIS J61924002T  
Vlera e ofertës = 81,433,115.7 (tetëdhjetë e një milion e katërqind e tridhjetë e tre mijë e njëqind e pesëmbëdhjetë pikë shtatë) lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

**Operatori ekonomik “L.T.E CONSTRUCTION” shpk** NUIS 78006801F  
Operatori ekonomik “L.T.E CONSTRUCTION” shpk nuk plotëson kërkesën sipas pikës 1 të kapacitetit teknik: *“Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën...”* pasi nga shqyrtimi i kontratave të paraqitura si punë e ngjashme rezulton se kontratat me objekt: 1. “Rikonstruksion godine ekzistuese me 2-kat dhe 1-kat...”, 2. “Instalimi i sistemit ujëmatës në burimet e ujësjellësit Tiranë”; 3. “Rikonstruksion rrjet ujësjellësi të rrjetit të vjeter...”; 4. “Ndërtim rrjet ujësjellësi në zonën që kufizohet nga rrugët Vangjel Noti.....”; 5. “Ndërtimi i rrjetit ujësjellës në rrugën Xhorxh Martini.....”; 6. “Rikonstruksion rrjet ujësjellës në adresën Zogu i Zi...” rezultojnë kontrata me objekt të ndryshëm nga ai që po prokurohet. Ndërsa kontratat me objekt të ngjashëm nuk plotësojnë vlerën e kërkuar cka bie në kundërshtim me kërkesat e gërmës “b” të pikës 1 të kapacitetit teknik: “Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht: 183,032,296 (njëqind e tetëdhjetë e tre million e tridhjetë e dy mijë e dyqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH”.

Operatori ekonomik “L.T.E CONSTRUCTION” shpk nuk plotëson kërkesën sipas pikës 6 të kapacitetit teknik: *“Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, të vertetuar me kontratë punë të vlefshme, diplome leshuar nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik (të vlefshme) leshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve), si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë/ 2(dy) punonjës elektrikiste”* pasi në Shtojcën 8, Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit është deklaruar vetëm 1 punonjës elektrikist nga 2 të kërkuar.

Operatori ekonomik “L.T.E CONSTRUCTION” shpk nuk plotëson kërkesën sipas pikës 6 të kapacitetit teknik: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht”* pasi në Shtojcën 8, Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit nuk është deklaruar mjeti i kërkuar spërkatës boje.

**Bashkimi i operatorëve ekonomike “XHENGO” shpk & “BOSHNJAKU. B” shpk**  
NUIS J64103171M; K72627402H

Operatori ekonomik “BOSHNJAKU. B” shpk nuk plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit të DST piken 3, të kapacitetit teknik ku citohet se: Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklarate Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të

jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqeruar me dokumentacionin e mëposhtme:a) Librezë punë;b) Kontratë punë e vlefshme;c) Diplomë. Nga verifikimi dokumentacionit të paraqitura në sistemin elektronik të prokurimit rezultoi se Operatori ekonomik “BOSHNJAKU. B” shpk nuk ka paraqitur deklaratën për Drejtuesin Teknik të punimve në objekt kërkuar në piken 3, ku përcaktohet se: *“Ne rastin e Bashkimit të Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varesi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë përsipër sipas përqindjes së bashkepunimit”*.

Operatori ekonomik Xhengo shpk, nuk plotëson piken 11, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik ku përcaktohet se: *Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatën e menaxhimit të energjisë ISO 50001-2011 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”*. pasi nga verifikimi në sistemin elektronik të prokurimit rezultoi se operatori ekonomik Xhengo shpk, ka paraqitur çertifikatën ISO 50001:2011 e cila është çertifikate e pa akredituar nga Drejtoria përgjithshme e Akreditimit apo nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, gjithashtu nuk është deklaruar në formularin përmbledhës të vetedeklarimit, të paraqitur në sistemin elektronik të prokurimit.

Operatori ekonomik “BOSHNJAKU. B” shpk nuk plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit të DST piken 8, të kapacitetit teknik ku citohet se: Operatori/ët ekonomik duhet të ketë në stafin e tij 1 (një) punonjës inxhinier si "Përgjegjës për dëmet në mjedis" gjatë kryerjes së veprimtarisë, në përputhje me klauzolat e ligjit Nr.10431 datë 09.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, (i ndryshuar), shoqëruar me kontratë individuale punë të vlefshme, Diplome/certificate leshuar nga autoritetet të akredituara përgjegjëse shtetërore, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. *(Në rastin e Bashkimit të Operatoreve ekonomike, secili prej Operatoreve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Përgjegjës për dëmet në mjedis”*). Nga verifikimi formularit përmbledhës të vetedeklarimit, të paraqitur nga operatori ekonomik “BOSHNJAKU. B” shpk rezultoi se nuk ka deklaruar 1 (një) punonjës inxhinier si "Përgjegjës për dëmet në mjedis".

Operatori ekonomik “XHENGO” shpk nuk plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit të DST piken 5, të kapacitetit teknik ku citohet se: *“Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në liçensën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë punë të vlefshme, librezë punë, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht: 1 (një) inxhinier Elektrik”*. Nga verifikimi dokumentacionit të paraqitura në sistemin elektronik të prokurimit konkretisht të Kontrates së Bashkepunimit date 27.10.2022 si dhe tabelës së ndarjes së punimve mes operatoreve sipas kontrates së bashkepunimit, rezultoi se operatori ekonomik “XHENGO” shpk ka marrë përsipër 88% të punimeve ku përfshihen edhe zerrat e punimeve elektrike, cka bie në kundërshtim me dokumentat standarte të tenderit pasi operatori ekonomik “XHENGO” shpk nuk ka deklaruar në formularin përmbledhës të vetedeklarimit Inxhinier Elektrik.

Bashkimi i operatoreve ekonomik “XHENGO & BOSHNJAKU. B” shpk nuk përmbushin kërkesat e përcaktuara në piken 12, Kapaciteti Teknik, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në DST, ku përcaktohet: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund të vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nëvojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8)”*. Nga verifikimi i formulareve përmbledhës të vetedeklarimit, në shtojcën e makinerive rezultoi se bashkimi i operatoreve ekonomik “XHENGO & BOSHNJAKU. B” shpk nuk ka deklaruar 1 (një) Autobitumatrice.

### **Bashkimi i operatorëve ekonomike “BEQIRI” shpk & “B93 II” shpk**

**NUIS J98624801V; L522090500**

Operatori ekonomik “BEQIRI” shpk nuk plotëson kërkesat sipas pikes 11, germa D te DST, Kapaciteti Teknik, ku citohet se: Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë: Çertifikatën e menaxhimit te energjise ISO 50001-2011 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, Operatori ekonomik që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit do të marrë përsipër realizimin e zërave elektrikë të Preventivit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO). Pas verifikimit te dokumentacionit te dorezuar në sistemin elektronik te prokurimeve rezulton se operatori ekonomik “Beqiri” shpk sipas marreveshjes se bashkëpunimit ka marre përsipër zera punimesh elektrike e për rrjedhoje duhet te kishte dorezuar ISO 50001-2011 sipas zerave te punimeve, qe ka marre përsipër te realizoje.

### **Operatori ekonomik “ALBAVIA” shpk**

**NUIS J81527001Q**

Operatori ekonomik ALBAVIA shpk, nuk plotëson piken 13, te Kriteve te Vecanta te Kualifikimit, Kapaciteti Teknik ku përcaktohet se: *Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatën e menaxhimit te energjise ISO 50001-2011 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë*”. pasi nga verifikimi në sistemin elektronik te prokurimit rezulton se operatori ekonomik ALBAVIA shpk, ka paraqitur çertifikaten ISO 50001:2011 e cila është çertifikate e pa akredituar nga Drejtoria përgjithshme e Akreditimit apo nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

### **Operatori ekonomik “K A C D E D J A” shpk**

**NUIS K51712017A**

Operatori ekonomik “K A C D E D J A” shpk nuk plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit te DST piken 3, te kapacitetit teknik ku citohet se: “Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklaroje se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqeruar me dokumentacionin e mëposhtme:Librezë punë; Kontratë punë e vlefshme; Diplomë. ” Nga verifikimi dokumentacionit te paraqitura në sistemin elektronik te prokurimit rezultoi se Operatori ekonomik “K A C D E D J A” shpk ka paraqitur deklaratën për Drejtuesin Teknik te punimeve në objekt me inicialit M.S, me profesion Inxhinierë Mjedisi, cka bie në kundërshtim me Udhezimin Nr.2, date 13.05.2005, Kreu I, pika 2.1, paragrafi 2, ku citohet se: “Për vepra me vlerë të plotë, të preventuar mbi 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë punë të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi”.

### **Operatori ekonomik “BAJRAMI N.” shpk**

**NUIS K027272020**

Operatori ekonomik Bajrami N. shpk, nuk plotëson piken 11, te Kriteve te Vecanta te Kualifikimit, Kapaciteti Teknik ku përcaktohet se: *Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit ISO 45001-2018, (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë*”. pasi nga verifikimi në sistemin elektronik te prokurimit rezulton se operatori ekonomik Bajrami N shpk, ka paraqitur çertifikaten ISO 45001:2015 e cila është çertifikate e pa akredituar nga Drejtoria përgjithshme e Akreditimit apo nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Operatori ekonomik Bajrami N. shpk, nuk plotëson piken 11, te Kriteve te Vecanta te Kualifikimit, Kapaciteti Teknik ku përcaktohet se: *Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatën e menaxhimit te energjise ISO 50001-2011, (e vlefshme) e akredituar nga DPA*

ose nga *Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë*". pasi nga verifikimi në sistemin elektronik te prokurimit rezulton se operatori ekonomik Bajrami N. shpk, ka paraqitur çertifikaten ISO 50001:2015 e cila është çertifikate e pa akredituar nga Drejtoria përgjithshme e Akreditimit apo nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

**Operatori ekonomik "S I R E T A 2F" shpk. NUIS K51501008J**

Operatori ekonomik "S I R E T A 2F" shpk, nuk ploteson piken 13, te Krieteve te Vecanta te Kualifikimit, Kapaciteti Teknik ku percaktohet "*Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatën e menaxhimit te energjise ISO 50001-2011 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, Operatori ekonomik që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit do të marrë përsipër realizimin e zërave elektrikë të Preventivit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).*" pasi nga verifikimi ne sistemin elektronik te prokurimit rezulton se operatori ekonomik "S I R E T A 2F" shpk nuk ka paraqitur Çertifikaten ISO- 50001:2011.

**Operatori ekonomik "LEON KONSTRUKSION" shpk NUIS K71820009I**

Operatori ekonomik "LEON KONSTRUKSION" shpk nuk përmbush kerkesat e përcaktuara në piken 12, Kapaciteti Teknik, Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, në DST, ku përcaktohet: "*Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nëvojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) Autobitumatriçe, Copë 1, Në pronësi ose me qera*"; Nga verifikimi formularit përmbledhes te vetedeklarimit, në shtojcen e makinerive rezulton se operatori ekonomik "LEON KONSTRUKSION" Shpk nuk ka deklaruar mjet Autobitumatriçe, cka bie në kundërshtim me kerkesat për plotesimin dhe deklarimet në formularin përmbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces 8.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin ekonomik "DAJTI PARK 2007" shpk**, me adresë Rr. Bardhok Biba, Pallati Trema, Hyrja C, KODI POSTAR 1016, Tiranë se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 57,503,314 (*pesëdhjetë e shtatë milion e pesëqind e tre mijë e treqind e katërbëdhjetë*) lekë pa tvsh është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Autoritetit Kontraktor, Bashkia e Tiranës* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5(pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej 61,423,988 (*gjashtëdhjetë e një milion e katërqind e njëzet e tre mijë e nëntëqind e nëntëqdhjetë e tetë*) lekë pa TVSH, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik".

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraprak)

PO X JO

Nëse Po: Vendim Nr.127/2023, për zbatimin e Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.70/2023 datë 31.01.2023.

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të Procedurës:

PO  JO

Nëse Po (*vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë*) \_\_\_\_\_